



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**  
**DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË**

K.Dh.Sh.II.nr.1025/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Albed” SH.P.K., me seli në Vushtrri, rr.“Kongresi i Manastirit”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit T.H. avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Kanun” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rr.“Bulevardi i Dëshmorëve” 72 A, nr.7, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit G.V. avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.849/2022 të datës 28.04.2023, me datë 23.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa debitorit Kanun SH.P.K me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.849/2022 i datës 28.04.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.849/2022 të datës 28.04.2023, në pikën I. të dispozitivit ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Kanun” SH.P.K., me numër unik identifikues 810807688, të paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.549/2021, të lejuar me datë 09.12.2021, nga përmbartuesi privat Rrezarta Metaj. Në pikën II të dispozitivit Urdhrin përmbartimor P.nr.549/2021, të lejuar me datë 09.12.2021, nga përmbartuesi privat Rrezarta Metaj, e ka lënë në fuqi. Në pikën III të dispozitivit ka Detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 312.00 (treqind e dymbëdhjetë Euro), në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar i autorizuari i debitorit për shkak se dhoma e shkallës së parë gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit, ka dështuar të shqyrtoj pretendimet kryesore të debitorit me ç,rast ka rënë në shkelje të dispozitave materiale të LPP-së. dhe LPK-së, i propozon gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të themelit ankesën e debitorit, të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, duke e kundërshtuar ankesën e debitorit, me propozim që të refuzohet ankesa në tërësi si e pathemeltë dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e autorizuarit të debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorit “Albed” SH.P.K., me seli në Vushtrri, rr.“Kongresi i Manastirit”, përmes të autorizuari të tij me datës 09.12.2021 ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit “Kanun” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rr.“Bulevardi i Dëshmorëve” 72 A, nr.7, në bazë të dokumentit përmbartimor aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.367/2018 të datës 28.02.2020, i plotfuqishëm nga data 06.10.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 09.11.2021.

Përmbartuesja private Rezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.549/2021 të datës 09.12.2021, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbartues, duke vlerësuar se dokumenti përmbartues i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor i autorizuari i debitorit me datë 21.12.2021, ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetim se aktgjykimi mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor shkelje të shumta materiale dhe se ndaj të njëjtit është paraqitur revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, ashtu që ekzekutimi sipas urdhrin, para vendosjes së Gjykatës Supreme lidhur me revizionin e debitorit, këtij të fundit do ti shkaktonte dëm të riparueshëm. Andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi dhe urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit me datë 29.12.2021, duke theksuar se prapësimi i paraqitur nga debitori është i pabazuar dhe i pambështetur në prova dhe se revizioni i paraqitur nga kreditori ndaj aktgjykimit mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor, nuk është pengesë për zhvillimin e procedurës përmbartimore. Andaj ka propozuar që prapësimi i ushtruar nga debitori të refuzohet si i pabazuar ashtu që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.849/2022 të datës 28.04.2023, në pikën I të dispozitivit ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa në pikën II të dispozitivit Urdhrin përmbartimor P.nr.549/2021 të datës 09.12.2021 e ka lënë në fuqi

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, Dhoma e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për arsye se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin në mbështetje të nenit 21, 22 paragrafi 1 të LPP-së, se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafi 1 dhe 36 paragrafi 1 të LPP-së.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Konkludimin e dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore apo kontestimore të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përmbarimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbarues në bazë të cilit është lejuar përmbarimi është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.367/2018 i datës 28.02.2020, i plotfuqishëm nga data 06.10.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 09.11.2021, i cili në rastin konkret është dokument përmbarues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese”*, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të autorizuarit të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoi përmbarimin.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore si dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, sepse në procedurën përmbarimore gjykata me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke ju përmbajtur parimit të rigozitetit formal-juridik që nënkupton se gjykata do të vlerësoj shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera që i përkasin shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, pasi që këto pretendime kanë mundur të paraqiten në kohën kur është marrë dokumenti përmbarues.

Dhomat e shkallës së dytë nuk i pranon si të bazuara pretendimet ankimore të debitorit, lidhur me atë se përmbarimi duhet të anulohet deri sa të vendoset lidhur me revizionin e debitorit, kjo për faktin se me dispozitën e nenit 213 të LPK-së, përcaktohet se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*. Në kuptim të kësaj dispozite kjo gjykatë vlerëson se revizioni i paraqitur nga debitori nuk është pengesë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe rrjedhimisht edhe në këtë drejtim rezultojnë si të pathemelta pretendimet ankimore të autorizuarit të debitorit të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pathemelta.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit, por nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkaqe për të vendosur ndryshe në këtë çështje, prandaj nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.1025/2023 me datë 23.02.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha